



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2878/25 prot

Datë 28.05.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 590/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.05.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:**

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 57/2024, datë 16.01.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “EN-BJO” SHPK, me NIPT (K872172050), me adresë: Lagjja “Pavarësia”, Bulevardi “Ismail Qemali”, Pallati Nr.458, Hyrja Nr.11, Kati 1, Vlorë

**Autoriteti Kontraktor:**

“Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”, me adresë: Lagjja, Kushtrimi; Rruga “Dervish Hekali” Vlorë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 16.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 57/2024, datë 16.01.2024, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “En - Bjo” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “En - Bjo” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “En - Bjo” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 58/1 prot., datë 24.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 2878/11 prot., datë 26.01.2024, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 57/2024, datë 16.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.

I.3. Në datë 29.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 107/2024, datë 29.01.2024, ku vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.
2. Autoriteti kontraktor, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.4. Autoriteti kontraktor, në datën 08.02.2024, ka dorëzuar praë KPP shkresën nr. 58/6 prot., datë 06.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 2878/16 prot., datë 08.02.2024, me objekt “Kërkesë për asistencë”.

I.5. Në datë 22.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 209/2024, datë 22.02.2024, ku vendosi:

1. *Të mos lejohet autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “NSHP, BOJË FOSFORESHENTE”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”.*
2. *Autoriteti kontraktor, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.6. Autoriteti kontraktor, në datën 07.05.2024, ka dorëzuar praë KPP shkresën nr. 354/3 prot., datë 07.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 2878/22 prot., datë 09.05.2024, me objekt “Rishqyrtim i dokumentacionit tekniko ligjor të operatorit ekonomik “En-Bjo” për procedurën e prokurimit “Bojë fosforeshente”, REF-83646-10-13-2023” informon se:

*“Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë ka kërkuar sqarim për pikën III.2.10 të Vendimit nr.57/2023 të KPP për procedurën e prokurimit me object “Bojë fosforeshente”, me REF-83646-10-13-2023 me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), bazuar në Urdhërin nr. 51 datë 03.05.2024 me nr. 352/2 prot., datë 03.05.2024 “Mbi ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit “, dalim në përfundimin e mëposhtëm: Bazuar në shkresën me nr. 354/2 prot., datë 17.04.2024 të operatorit ekonomik “En – Bjo” SHPK ku ka bashkëngjitur katalogun dhe sqarime për peshës specifike të bojës na rezulton se nuk I përmbush specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi është kërkuar  $1.75 \pm 0.10$  kg/ltd he është ofruar  $1.60 \pm 0.05$  gr/ml. Sa më sipër pretendimi I OE ankimes En -Bjo shpk nuk qëndron.”*

I.7. Në datën 17.05.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar në adresën zyrtare të emailit të Komisionit të Prokurimit Publik [kpp\\_info@kpp.gov.al](mailto:kpp_info@kpp.gov.al), dokumentat bashkëlidhur (Dokumentacion operatori 1.pdf; Rishqyrtim dokumentacioni.pdf; Urdher i brendshem.pdf; Dokumentacion operatori.pdf; Dokumentacion operatori2.pdf), ku rezulton se janë dorëzuar:

- Shkresën nr.05 prot., datë 17.04.2024, nga operatori ekonomik “En-Bjo” SH.P.K., protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr. 354/2 prot., datë 17.04.2024, ku operatori ekonomik informon se: “Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr. 354 prot., datë 15/04/2024 “Kërkesë për sqarim” në lidhje me procedurën e prokurimit “NSHP, Bojë Fosforeshente” po ju dërgojmë bashkëngjitur skedën teknike të bojës së vijëzimit të prodhuesit

*DEUTHCOLOR me të cilën kam konkuruar dhe të cilën e keni dhe në dokumentacionin e hedhur nga Ne në APP. Theksojmë se në Fletën Teknike do të gjeni të gjitha sqarimet e nevojshme.”*

- Fletë të Dhënash Teknike DEUTHCOLOR
- Urdhër Nr. 51 datë 03.05.2024 “Mbi ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit”, ku citohet “1. Ngritjen e grupit të punës për rishqyrtimin e dokumentacionit tekniko ligjor të operatorit ekonomik “EN-BJO” shpk për procedurën e prokurimit me objekt “NSHP, Bojë Fosforeshente”, REF-83646-10-13-2023 [...]”
- Shkresën nr.354/3 prot., datë 07.05.2024, të autoritetit kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, me objekt “Rishqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të operatorit ekonomik “EN-BJO” SHPK për procedurën e prokurimit “NSHP, Bojë Fosforeshente””, ku ndër të tjera citohet: “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë ka kërkuar sqarim për pikën III.2.10 të Vendimit nr. 57/2023 të KPP për procedurën e prokurimit me objekt “Bojë Fosforeshente”, me REF-83646-10-13-2023, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, bazuar në Urdhërin nr. 51 datë 03.05.2024 me nr. 352/2 prot., datë 03.05.2024 “Mbi ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit” dalim në përfundimin e mëposhtëm: Bazuar në shkresën me nr. 354/2 prot., datë 17.04.2024 të operatorit ekonomik “EN-BJO” SHPK ka bashkëngjitur katalogun dhe sqarime për peshës specifike të bojës na rezulton se nuk i përmbush specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor pasi është kërkuar  $1.75 \pm \text{kg/lt}$  dhe është ofruar  $1.60 \pm 0.05 \text{ gr/ml}$ . Sa më sipër pretendimi i OE ankimues EN-BJO shpk nuk qëndron.”

## II

### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### Arsyeton

II.1. Me anë të shkresës nr. 354/3 prot., datë 07.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 2878/22 prot., datë 09.05.2024, me objekt “Rishqyrtim i dokumentacionit tekniko ligjor të operatorit ekonomik “En-Bjo” për procedurën e prokurimit “Bojë fosforeshente”, REF-83646-10-13-2023” informon se: “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë ka kërkuar sqarim për pikën III.2.10 të Vendimit nr.57/2023 të KPP për procedurën e prokurimit me object “Bojë fosforeshente”, me REF-83646-10-13-2023 me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), bazuar në Urdhërin nr. 51 datë 03.05.2024 me nr. 352/2 prot., datë 03.05.2024 “Mbi ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit “, dalim në përfundimin e mëposhtëm: Bazuar në shkresën me nr. 354/2 prot., datë 17.04.2024 të operatorit ekonomik “En – Bjo” SHPK ku ka bashkëngjitur katalogun dhe sqarime për peshës specifike të bojës na rezulton se nuk i përmbush specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi është kërkuar  $1.75 \pm 0.10 \text{ kg/lt}$  dhe është ofruar  $1.60 \pm 0.05 \text{ gr/ml}$ . Sa më sipër pretendimi i OE ankimues En -Bjo shpk nuk qëndron.”

II.2. Në datën 17.05.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar në adresën zyrtare të emailit të Komisionit të Prokurimit Publik [kpp\\_info@kpp.gov.al](mailto:kpp_info@kpp.gov.al), dokumentat bashkëlidhur (*Dokumentacion operatori 1.pdf*; *Rishqyrtim dokumentacioni.pdf*; *Urdher i brendshem.pdf*; *Dokumentacion operatori.pdf*; *Dokumentacion operatori2.pdf*), ku rezulton se janë dorëzuar:

- Shkresën nr.05 prot., datë 17.04.2024, nga operatori ekonomik “En-Bjo” SH.P.K., protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr. 354/2 prot., datë 17.04.2024, ku operatori ekonomik informon se: *“Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr. 354 prot., datë 15/04/2024 “Kërkesë për sqarim” në lidhje me procedurën e prokurimit “NSHP, Bojë Fosforeshente” po ju dërgojmë bashkangjitur skedën teknike të bojës së vijëzimit të prodhuesit DEUTHCOLOR me të cilën kam konkuruar dhe të cilën e keni dhe në dokumentacionin e hedhur nga Ne në APP. Theksojmë se në Fletën Teknike do të gjeni të gjitha sqarimet e nevojshme.”*
- Fletë të Dhënash Teknike DEUTHCOLOR
- Urdhër Nr. 51 datë 03.05.2024 *“Mbi ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit”,* ku citohet *“1. Ngritjen e grupit të punës për rishqyrtimin e dokumentacionit tekniko ligjor të operatorit ekonomik “EN-BJO” shpk për procedurën e prokurimit me objekt “NSHP, Bojë Fosforeshente”, REF-83646-10-13-2023 [...]”*
- Shkresën nr.354/3 prot., datë 07.05.2024, të autoritetit kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, me objekt *“Rishqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të operatorit ekonomik “EN-BJO” SHPK për procedurën e prokurimit “NSHP, Bojë Fosforeshente””,* ku ndër të tjera citohet: *“Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë ka kërkuar sqarim për pikën III.2.10 të Vendimit nr. 57/2023 të KPP për procedurën e prokurimit me objekt “Bojë Fosforeshente”, me REF-83646-10-13-2023, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, bazuar në Urdhërin nr. 51 datë 03.05.2024 me nr. 352/2 prot., datë 03.05.2024 “Mbi ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit” dalim në përfundimin e mëposhtëm: Bazuar në shkresën me nr. 354/2 prot., datë 17.04.2024 të operatorit ekonomik “EN-BJO” SHPK ka bashkëngjitur katalogun dhe sqarime për peshës specifike të bojës na rezulton se nuk i përmbush specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor pasi është kërkuar  $1.75 \pm \text{kg/l}$  dhe është ofruar  $1.60 \pm 0.05 \text{ gr/ml}$ . Sa më sipër pretendimi i OE ankimues EN-BJO shpk nuk qëndron.”*

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe dokumentacionit të dorëzuar me anë të postës elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer të gjitha hapat procedural të nevojshëm, në përputhje me vendimin Nr. 57/2024, datë 16.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, ka zbatuar vendimin K.P.P 57/2024, datë 16.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-83646-10-13-2023, me objekt: “*NSHP, BOJË FOSFORESHENTE*”, me fond limit 3,000,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26.10.2023 nga autoriteti kontraktor, “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**